



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 682 Prot.

Tiranë, më datë 18.12.2025

**VENDIM**

**Nr. 613, datë 19.12.2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.12.2025:

**VENDOSI**

1. Miratimin e projekt idesë “*Rijetëzimi i Kalasë së Lëkurësit, Sarandë*”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues AD-STAR dhe zhvillues subjekti **2AQ sh.p.k., me rekomandimet që në projekt zbatim:**
  - Të përfshihen në preventiv zërat për prishjen e ndërtimeve pa leje;
  - Projekti elektrik të vijë më i detajuar ku të përfshihet kalimi i linjës elektrike në monument, si dhe konfigurimi i ndriçuesve;
  - Të detajohen tabelat informuese në hyrje të Kalasë së Lëkurësit;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Kiara XHELILI**

**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**